




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



RREGULLORE
PËR
MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJE SHIRJEVE

Q E R S H O R 2010

Në bazë të nenit 12 pika 2 paragrafi c) të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40 dhe nenit 20 pika 1 paragrafi c) të Statutit të Komunës së Junikut i datës 27.11.2008, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur me datën 28.07.2010, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJE – SHIRJEVE

Neni 1

Bazuar në rendësin dhe kohën e shkurtër që ka fushata e Korrje –shirjes komuna përmes kësaj rregullore përcakton mënyrën e organizimit të fushatës së korrje –shirjes në territorin e Komunës së Junikut.

Neni 2

Për organizimin dhe përcjelljen e fushatës së Korrje-shirjes Komuna do ta formoj Shtabin Komunal për Korrje –shirje.

Detyrat dhe përgjegjësit e shtabit i përcakton me vendim të veçantë Kryetari i Komunës. Shtabi i Komunal për Korrje – shirje do të përgatisë një raport për mbarëvajtjen e fushatës i cili i dorëzohet Kryetarit dhe Asamblesë Komunale.

Neni 3

Çmimi i korrje - shirjes do të jetë në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë ,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Drejtoria për Ekonomi,Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

Neni 4

Autokombajnjerët duhet t'u përmbahen rregullave të korrje – shirjeve, siç janë :

- a- që korrjen dhe shirjen ta kryejnë në afatin e paraparë dhe me cilësi e cila siguron që humbja e drithit të mos jetë më e madhe se **3 %**,
- b- lartësia e korrjes (stërnishtës) të mos jenë më e lartë se **15 cm**,
- c- të respektojnë çmimin e preferuar për kryerjen e korrje - shirjes.
- d- që me kohë të bëjnë të gjitha përgatitjet teknike dhe të tjerat për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve.

Neni5

Autokombajnjerët duhet të trajtojnë të gjithë bujqit në mënyrë korrekte dhe pa asnjë dallim, të mbajnë evidence të saktë për korrje – shirje, në autokombajnë duhet të jetë e shënuar qartë shenja kundër zjarrit, e cila duhet edhe të respektohet nga të gjitha palët, të posedoj aparatin zjarrfikës dhe mjete tjera ndihmëse.

Neni 6

Prodhuesit bujqësor janë të obliguar :

- që me kohë të përgatisin ngastrat e tyre për kryerje pa pengesa të korrjeve dhe shirjeve (pastrimin e barojave të këqija, shkurreve, eliminimin eventual të gardhiqeve dhe pengesave tjera) .
- që të sigurojnë rrugët kaluese te ngastrat (mbyllja e kanaleve, rrafshimi i terenit).

Neni 7

Për kushtet e korrje – shirjeve autokombajnjerët dhe bujqit duhet të informohen me kohë.

Neni 8

Shtabi Komunal për korrje-shirje i percaktuar në nenin 2 të kësaj Rregulloreje është i autorizuar:

- a). që të kontrollojë respektimin e afateve të percaktuara për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt teknike të makinave korrëse – shirëse, orarin e kryerjes së korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt të instrumenteve për matje, mbrojtjes në punë, mjeteve mbrojtëse kundër zjarrit e të ngjashme,
- b). që të ndaloj punën e makinave (autokombajnave), për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve në rastet e gjendjes jo të rregullt teknike, ose të humbjes së drithit mbi 3 %.

Neni 9

Me dënim me të holla prej 100 € deri 200 € do të dënohet pronari i makinës për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, nëse punon me kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Shtabi Komunal për Korrje-Shirje dhe sektori i Inspektionit të komunës së Junikut..

Neni 11.

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendit i Komunës .




Kryesuesi i Asamblesë Komunale

Sinan Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



RREGULLORE
PËR
MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJE SHIRJEVE

Q E R S H O R 2010

Në bazë të nenit 12 pika 2 paragrafi c) të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-40 dhe nenit 20 pika 1 paragrafi c) të Statutit të Komunës së Junikut i datës 27.11.2008, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur me datën 28.07.2010, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJE – SHIRJEVE

Neni 1

Bazuar në rendësin dhe kohën e shkurtër që ka fushata e Korrje –shirjes komuna përmes kësaj rregullore përcakton mënyrën e organizimit të fushatës së korrje –shirjes në territorin e Komunës së Junikut.

Neni 2

Për organizimin dhe përcjelljen e fushatës së Korrje-shirjes Komuna do ta formoj Shtabin Komunal për Korrje –shirje.

Detyrat dhe përgjegjësit e shtabit i përcakton me vendim të veçantë Kryetari i Komunës. Shtabi i Komunal për Korrje – shirje do të përgatisë një raport për mbarëvajtjen e fushatës i cili i dorëzohet Kryetarit dhe Asamblesë Komunale.

Neni 3

Çmimi i korrje - shirjes do të jetë në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë ,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Drejtoria për Ekonomi,Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

Neni 4

Autokombajnjerët duhet t'u përmbahen rregullave të korrje – shirjeve, siç janë :

- a- që korrjen dhe shirjen ta kryejnë në afatin e paraparë dhe me cilësi e cila siguron që humbja e drithit të mos jetë më e madhe se **3 %**,
- b- lartësia e korrjes (stërnishtës) të mos jenë më e lartë se **15 cm**,
- c- të respektojnë çmimin e preferuar për kryerjen e korrje - shirjes.
- d- që me kohë të bëjnë të gjitha përgatitjet teknike dhe të tjerat për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve.

Neni 5

Autokombajnjerët duhet të trajtojnë të gjithë bujqit në mënyrë korrekte dhe pa asnjë dallim, të mbajnë evidence të saktë për korrje – shirje, në autokombajnë duhet të jetë e shënuar qartë shenja kundër zjarrit, e cila duhet edhe të respektohet nga të gjitha palët, të posedoj aparatin zjarrfikës dhe mjete tjera ndihmëse.

Neni 6

Prodhuesit bujqësor janë të obliguar :

- që me kohë të përgatisin ngastrat e tyre për kryerje pa pengesa të korrjeve dhe shirjeve (pastrimin e barojave të këqija, shkurreve, eliminimin eventual të gardhiqeve dhe pengesave tjera) .
- që të sigurojnë rrugët kaluese te ngastrat (mbyllja e kanaleve, rrafshimi i terenit).

Neni 7

Për kushtet e korrje – shirjeve autokombajnjerët dhe bujqit duhet të informohen me kohë.

Neni 8

Shtabi Komunal për korrje-shirje i percaktuar në nenin 2 të kësaj Rregulloreje është i autorizuar:

- a). që të kontrollojë respektimin e afateve të përcaktuara për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt teknike të makinave korrëse – shirëse, orarin e kryerjes së korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt të instrumenteve për matje, mbrojtjes në punë, mjeteve mbrojtëse kundër zjarrit e të ngjashme,
- b). që të ndaloj punën e makinave (autokombajnave), për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve në rastet e gjendjes jo të rregullt teknike, ose të humbjes së drithit mbi 3 %.

Neni 9

Me dënim me të holla prej 100 € deri 200 € do të dënohet pronari i makinës për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, nëse punon me kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Shtabi Komunal për Korrje-Shirje dhe sektori i Inspekcionit të komunës së Junikut..

Neni 11.

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendit i Komunës.



Kryesuesi i Asamblesë Komunale
Shan Sacaferi